

## Informacione në lidhje me koronavirusin:

### Nuk ndihem mirë. Çfarë duhet të bëj?

1. Në rast de keni simptoma si temperaturë të lartë, kollë apo gulç, vështirësi në frymëmarrje, ju lutemi të telefononi mjekun/mjekën tuaj të familjes.

Mjeku mund të vendos, nëse në rastin tuaj është nevojshme kryerja e testimit për koronavirusin. Në rast se po, mjeku do t'ju japë rekomandim për testimin.

2. Jashtë orareve zyrtare të klinikës, ju mund të telefononi pranë shërbimit mjekësor urgjent në numrin 116 117.

3. Respektoni udhëzimet e dhëna nga mjekët.

#### E rëndësishme:

- MOS shkoni në klinikën e mjekut pa u njoftuar dhe pa ua kërkuar mjeku një gjë të tillë.
  - Deri në sqarimet e mëtejshme, qëndroni në shtëpi ose në dhomën tuaj. Kufizoni deri në minimum kontaktin me personat e tjerë.
  - Respektoni rregullat e higjienës.
4. Nëse ju jetoni në një qendër të përbashkët banimi, informoni menjëherë punonjësin përgjegjës të shërbimit për integrimin.
  5. Ju duhet të hyni në karantinë shtëpiake,
    - nëse ndiheni shumë i sëmurë dhe dyshoni të jeni infektuar me koronavirus ose
    - nëse tek ju është konstatuar tashmë koronavirusi ose
    - nëse ju keni pasur kontakt personal me një person të infektuar.

Në një rast të tillë, ju lutemi të lexoni me kujdes dekretin e përgjithshëm të Landratsamtes Heilbronn në lidhje me karantinën shtëpiake. Ju duhet t'i zbatoni urdhëresat, kërkesat dhe udhëzimet në të. Dekretin e përgjithshëm do ta gjeni në faqen kryesore të Landratsamtes nën linkun [www.landkreis-heilbronn.de/informationen-zum-coronavirus.44148.htm](http://www.landkreis-heilbronn.de/informationen-zum-coronavirus.44148.htm).

6. Në rast se keni pyetje në lidhje me koronavirusin, mund të telefononi në linjën telefonike hotline të klinikës SLK-Kliniken, atë të bashkisë dhe të Qarkut të Landit Heilbronn. Linja telefonike hotline mund të arrihet çdo ditë nga ora 8 deri 20 nën numrin 07131 4933333.